



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT

FUSHA: ARTET dhe TEKNOLOGJIA

MODULI: FOTOGRAFI/ FOTOSHOP

KODI: 1.01

**PROGRAMI I MODULIT FOTOGRAFI/ FOTOSHOP
PËR KLASËN E 10**

TIRANË, NËNTOR 2008

Ky modul luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e aftësive estetike dhe profesionale të nxënësve në fushën e fotografisë. Njohuritë dhe veprimtaritë praktike që nxënësit do të kryejnë gjatë zhvillimit të këtij moduli do t'i motivojnë ata të përfshihen në jetën artistike të shkollës, duke komunikuar dhe realizuar aftësitë e tyre artistike nëpërmjet fotografisë dhe programit të fotoshop -it. Njohuritë dhe aftësitë e marra përmes studimit të këtij moduli do të jenë një bazë e mirë dhe orientim për drejtimin e mëvonshëm profesional të nxënësve si dhe mundësi për t'u punësuar.

Moduli do t'i aftësojë nxënësit jo vetëm në anën teorike por dhe në anën praktike të realizimit dhe përpunimit të fotografisë.

1. SYNIMI I MODULIT

Ky modul synon:

aftësimin e nxënësve në komunikimin viziv nëpërmjet fotografisë, në përdorimin e aparaturave profesionale, përpunimin e fotove në fotoshop dhe zhvillimin e aftësive krijuese nëpërmjet realizimit të fotografive në gjini të ndryshme.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij moduli nxënës/i, - ja:

- të praktikojë përdorimin e aparatit fotografik, zhvillimin dhe stampimin e filmit;
- të përdorë komandat e fotoshop –it që lidhen me përpunimin e fotografisë;
- të përpunojë foto të ndryshme në këtë program;
- të realizojë foto në disa gjini, duke komunikuar ide, ndjenja dhe mendime;
- të kuptojë aspektet estetike dhe sociale të fotografisë dhe të marketingut.

3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

36 javë x 1 orë = 36 orë

Linja: Historia e fotografisë

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë njeh nxënësit me historinë e fotografisë që nga fillimet e saj e deri në ditët tona.

Orët e sugjeruara: 2

Linja	Objektiva
	Në përfundim të këtij moduli nxënës/i,-ja:

Historia e fotografisë	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë <i>eksperimentet e para</i> fotografike; • të përshkruajë <i>shpikjen e aparatit të parë fotografik</i>, e më pas atë të <i>filmit</i>; • të shpjegojë <i>progresin teknologjik</i> dhe shpikjen e <i>aparatit dixhital</i>.
-------------------------------	---

Linja 2: Aparati fotografik

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë nxënësit mësojnë ndërtimin dhe *përdorimin profesional të aparatit fotografik, larjen dhe stampimin e filmit.*

Orët e sugjeruara: 3

Linja	Objektiva
Aparati fotografik	<p>Në përfundim të këtij moduli nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë <i>ndërtimin dhe funksionimin</i> i aparatit fotografik mekanik dhe digital; • të përdorë profesionalisht aparatin; • të shpjegojë <i>funksionin dhe rëndësinë e dhomës së errët, larjes dhe stampimit të filmit</i>; • të zhvillojë një film në dhomën e errët <i>përmes procesit të larjes dhe stampimit</i>; • të përdorë aparatin fotografik digjital dhe hedhjen e fotove në kompjuter.

Linja 3: Fotoshopi

Përshkrimi i linjës: Në këtë linjë nxënësit mësojnë përdorimin e programit të fotoshop-it, në shërbim të përpunimit të fotografisë. Ata do ta shohin këtë program si një pjesë të rëndësishme të teknologjisë së sotme në shërbim të fotografisë.

Orët e sugjeruara: 15

Linja	Objektiva
Fotoshop - i	<p>Në përfundim të këtij moduli nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të instalojë programin e fotoshop-it; • të skanojë 1 foto, duke përdorur fotoshop-in; • të dallojë <i>elementet karakteristike</i> të fotografisë (rezolucioni, madhësia, tipi i letrës, sistemi i ngjyrave, përdorimi për desktop-in, përdorimi për publikim në Web, përdorimi për shtypshkronjë etj);

	<ul style="list-style-type: none"> • të përdorë komandat <i>bazë të programit të fotoshop-it</i> për qëllimin e: <ul style="list-style-type: none"> - shikimit të fileve, kamerës Raw, rregullimin e niveleve; - shkëlqimin e imazhit, rritjen e kontrastit, rregullimin selektiv; - ndriçimin e hijeve, errësimin e ekspozimit, heqjen e nuancës së ngjyrës; - prerjen, rregullimin e perspektivës; - heqjes së të kuqes së syrit, heqjes së grimcave; - reduktimit të zhurmës së ngjyrës, theksimit të imazhit, heqjes së objekteve që nuk duhen, retushimit të njerëzve, zbardhjes së dhëmbëve, zmadhimit të syrit; - konvertimit në tonalitetet e grisë, zbutjes së portreteve, përdorimit të ngjyrave në harmoni; - shkëmbimit të fytyrave- portrete në grup, imazhit të një pikturë; - diapazonit të ngjyrave/prerjes së imazhit, mënyrës së pastrimit të flokëve; - vendosjes së imazhit brenda një kornize në foto shop; - krijimit të thellësisë së një imazhi; - krijimit të një fotografie, duke përdorur pjesë nga foto të tjera; - përdorimit të efekteve të veçanta të filtrave; - zbatimit të komandave të dritares së printimit që ka fotoshopi. • të përpunojë <i>fotot e realizuara</i> gjatë procesit mësimor.
--	--

Linja 4: Gjinitë e fotografisë

Përshkrimi i linjës: Kjo linjë njihet nxënësit me gjinitë e fotografisë dhe me rëndësinë që kanë ato si në komunikimin viziv, ashtu edhe në atë të lidhjes dhe rëndësisë që kanë ato me profesione të ndryshme të artit dhe të mediave. Në këtë linjë nxënësit njihen me mënyrën e prezantimit dhe menaxhimit të fotografisë në fushën e marketingut.

Orët e sugjeruara: 16

Linja	Objektiva
	<p>Në përfundim të këtij moduli nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë <i>gjinitë e fotografisë</i> dhe rëndësinë e tyre në

Gjinitë e fotografisë	<p>komunikimin viziv siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pejsazhi, - portreti, - reportazhi, - publiciteti dhe moda, - natyra e qetë, - fotografia shkencore, - fotomontazhi dhe përdorimi i programit në fotoshop për realizimin e saj. <ul style="list-style-type: none"> • të krijojë fotografi në gjini të ndryshme, duke pasur parasysh lidhjen e tyre me profesione të ndryshme të artit dhe mediave; • të realizojë veprimtari të ndryshme krijuese (ekspozita fotografie etj.); • të realizojë projekte me tematika të ndryshme, ese, detyrave të ndryshme me karakter krijues etj.; • të analizojë fotografi të ndryshme në përshtatje me gjininë, funksionin dhe sipas parimeve kompozicionale të artit pamor; • të krahasojë dy fotografi të së njëjtës gjini me autorë të ndryshëm të së njëjtës periudhë; • të përdorë aspektet estetike që lidhen me kompozimin në fotot e tij; • të analizojë aspektet sociologjike të fotografisë. • të prezantojë në mënyrë profesionale krijimet e veta në veprimtari të ndryshme artistike në klasë, shkollë, mjedisin ku jeton, në komunitet dhe shoqëri; • të përshkruajë anët pozitive dhe jo pozitive në zhvillimin e profesionit të fotografit, duke u mbështetur në llojin dhe nivelin e arsimimit e talentin, kushtet e punës, mundësitë e punësimit, pagën etj. • të klasifikojë tregun të cilit do të duhet t’i drejtohet.
------------------------------	--

4. KËRKESAT QË KA MODULI FOTOGRAFI - FOTOSHOP-I NDAJ LËNDËVE TË TJERA

FOTOGRAFI - FOTOSHOP-i	TIK
Përdorimi i pajisjeve të Input-Outputit	Të përdorë pajisjet usb, cd, dvd etj., për shkrim dhe lexim materialesh.

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E MODULIT

Zbatimi i këtij moduli, *fotografi- fotoshop*, kërkon të vendosë theksin në rrugën dhe procedurat e veprimit shkencor me objektet mësimore, që metodat verbale dhe mekanike të përdorura gjerësisht sot, të zëvendësohen me përdorim të metodave shkencore dhe digitale. Moduli i *fotografi- fotoshop* duhet t'i nxitë nxënësit të jenë aktivë dhe të marrin përgjegjësi për të mësuarit e tyre; të përdorin strategji dhe teknika mësimore që nxitin ndërveprimin, pjesëmarrjen mësimore dhe mbështetin krijimet e tyre në *fotografi – fotoshop*. Zbatimi i modulit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare.

Objektivat e modulit

Objektivat e modulit janë për të gjithë nxënësit që do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tematika apo linja dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të modulit.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

Orët mësimore

Moduli i *fotografi- fotoshop* –it është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por kjo nuk do të thotë se mësimdhënia-mësimnxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor. Programi i fotoshopit dhe mënyra si ata e vendosin atë në shërbim të përpunimit të fotografisë, shërben për të kuptuar dhe dhënë funksionin dhe destinacionin e saj të dëshiruar. Nxënësit do të praktikojnë aparatën fotografik dhe do të krijojnë foto në gjini të ndryshme duke i argumentuar ato në mënyrë profesionale.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e modulit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë.

Domethënë, mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të linjave, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban :

- Përsëritjen brenda një linje apo tematike të njohurive-bazë të tij (njohja me zhvillimin historik të fotografisë, prezantimi i fotografive dhe slideve për prezantimin e veprimtarive të ndryshme artistike të shkollës etj.);
- Testimin e njohurive-bazë për programin e fotoshopit dhe gjinive të fotografisë;
- Realizimin e veprimtarive të ndryshme krijuese (ekspozita fotografie etj.);
- Realizimin e projekteve sipas tematikave të vendosura për realizimin e projektit, eseve, detyrave të ndryshme me karakter krijues;

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive dhe aftësive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- ***Aftësive të posaçme lëndore:***

Krijuese- krijimin në gjini të ndryshme të fotografisë.

Krijuese- përpunimin në fotoshop të një fotografie për të arritur një rezultat të dëshiruar.

Komunikuese- komunikimin e njohurive të mara, mendimeve, emocioneve dhe qëndrimeve ndaj realitetit dhe dukurive.

Analizuese- analizën e fotografive në përshtatje me gjininë, funksionin dhe sipas parimeve kompozicionale të artit pamor.

Krahasuese- krahasimin midis dy fotografie të së njëjtës gjini të realizuar nga autorë të ndryshëm në të njëjtën periudhë. Krahasimin midis fotove të realizuara nga vetë nxënësi për një temë të caktuar.

- ***Formimit të qëndrimeve***, si qëndrimi etiko-social etj., dhe gjatë punës në grupe.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësit duhet të punojnë detyra me tematikë në lidhje me gjinitë e fotografisë që ata studiojnë.

Për realizimin cilësor të modulit të *fotografi- fotoshop* është e domosdoshme që çdo shkollë të ketë laboratorin e (TIK) me një numër të mjaftueshëm kompjuterësh, printer, skaner, video kamera, aparate fotografik digjitale e pajisje të tjera të cilat shërbejnë për të realizuar këtë modul. Gjithashtu për zbatimin me sukses të këtij moduli është mirë që mësuesi të përdorë metodat e nxitjes gjatë procesit të vëzhgimit dhe krijimit, që shërben për një orientim dhe fokusim profesional.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e modulit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në modul. Objektivi i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

- Mësuesi zhvillon vetë e ndihmon nxënësit dhe bashkënxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi
- Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: krijon foto duke u bazuar në gjini të ndryshme të fotografisë, përpunon foto sipas hapave të programit të fotoshopit të renditura përmes këtij moduli etj.
- Vlerësimi gjatë punës individuale për krijimin dhe realizimin e fotove sipas gjinive të ndryshme.

- Vlerësimi i kontributit gjatë punës në grup për realizimin e një ekspozite fotografike.
- Vlerësimi për përdorimin e aparatit fotografik dhe aksesoreve të tij në procesin e bërjes së fotografive.
- Vlerësimi në orën e mësimit gjatë përpunimit të fotove në programin e fotoshop-it.
- Vlerësimi përmes detyrave ose angazhimeve individuale të nxënësve (detyra praktike, projekte, risi etj.)

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të jenë të lirshëm të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirë kryerjes së detyrave jashtë klase. Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë apo modul të caktuar. Ai mund të përmbajë krijime të ndryshme përgjatë vitit, si: foto të gjinive të ndryshme artistike para dhe pas përpunimit në programin e fotoshop –it, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive artistike apo dhe evenimenteve të ndryshme në shkollë, familje, shoqëri, komunitet etj. Ai i përngjet një albumi me anën e të cilit mësuesi, nxënësi vetë dhe prindërit e tij gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit të nxënësit. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësuesi rekomandon.